



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË

VENDIM
Nr.3. datë 19.02.2026

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 15 datë 17.02.2020, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 19/02/ 2026;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 26/02/ 2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtari i Kryesisë së Këshillit
Mjaftoni ZERAJ

Anëtari i Kryesisë së Këshillit
Dino Selimi

Anëtari i Kryesisë së Këshillit
Vladimir BAKIAJ

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Arben Gumeni





BASHKIA TEPELENË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3 prot.

Tepelenë, më 19.02.2026

I mbajtur sot, më datë 19.02.2026, ora 11:00, në zyrën e Këshillit Bashkiak Tepelenë, me Kryesinë e Këshillit, për të diskutuar rendin e ditës dhe për të përcaktuar datën e mbledhjes së radhës.

Marrin pjesë:

1. Arben Gumeni
2. Vladimir Bakiaj

Takimin e hapi Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni, i cili përshëndeti të pranishmit dhe sqaroi se mbledhja zhvillohet për miratimin e rendit të ditës dhe përcaktimin e datës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak për muajin shkurt 2026.

Rendi i ditës i propozuar për mbledhjen e radhës:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara, datë 29.01.2026 dhe datë 13.02.2026.
3. Projektvendim: “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fondin 6% të fondit të kushtëzuar për muajin janar 2026”.
4. Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin janar 2026”.
5. Projektvendim: “Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2025”.
6. Projektvendim: “Për detajimin e plan–buxhetit për fondet nga transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale, granti të bazuar në performancë me burim financimi buxheti i shtetit dhe të ardhurat e veta të trashëguara nga viti 2025”.
7. Projektvendim: “Për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të fondit nga granti i bazuar në performancë për vitin 2025, me burim financimi të huaj”.
8. Raporti i performancës së Këshilli Bashkiak Tepelenë për vitin 2025.
9. Çështje të tjera.
10. Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.

Pas diskutimit, Kryesia ra dakord për rendin e ditës si më sipër dhe vendosi që mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak të zhvillohet në datën 26.02.2026 ora 11.00.

Mbyllet mbledhja e Kryesisë.

Kryetari i Këshillit
Arben Gumeni

Sekretari i Këshillit
Valbona Çela

KRYESIA E KËSHILLIT

Znj. Mjaftoni Zeraj
Z. Dino Selimi
Z. Vladimir Bakiaj